

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**  
**DREJTORIA GJYQËSORE**

L ë n d a : Mbi zbatimin e nenit 256 të K.Pr.Penale.

**PROKURORISË SË RRETHIT GJYQËSOR**

Nga kontrollet e ushtruara si dhe nga gjykimi i çështjeve në Gjykatën e Lartë, rezulton se në jo pak raste nuk respektohen kërkesat e nenit 256 të Kodit Procedurës Penale lidhur me marrjen në pyetje të të arrestuarit ose të ndaluarit.


Sikundër del qartë nga përmbajtja e kësaj dispozite, prokurori merr në pyetje të arrestuarin ose të ndaluarin për rastet e arrestimit në flagrancë dhe të ndalimit. Në kundërshtim me përcaktimin e mësipërm që rrjedh nga kjo dispozitë procedurale, janë shumë të rralla rastet kur prokurori e ka realizuar vetë këtë të drejtë, duke ua lënë si detyrë oficerëve të policisë gjyqësore.

Me qëllim që të gjejë zbatim rigoroz dispozita e mësipërme, tërheqim vëmendjen që në të gjitha rastet e arrestimeve në flagrancë dhe të ndalimeve, marrja në pyetje e të arrestuarit apo të ndaluarit do të

kryhet vetëm nga prokurori, duke përmbushur njëherazi edhe detyrimet e tjera që parashikon neni 256 i Kodit të Procedurës Penale.

**PROKURORI I PËRGJITHSHEM**

**THEODHORI SOLLAKU**

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Theodhori Sollaku', written over the printed name.

